



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË PODUJEVËS PËR VITIN 2020

Prishtinë, korrik 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Shënim

Ky Raport i auditimit është gjeneruar për herë të parë përmes platformës elektronike për menaxhimin e auditimit (SITA). Po ashtu, këtë vit, përdoret shablloni i ri i Raportit të auditimit, sipas metodologjisë së përditësuar për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë. Raporti përfshinë për herë të parë edhe konkluzionin e veçantë për pajtueshmëri.

Jemi plotësisht të vetëdijshëm që aplikimi i të gjitha këtyre risive njëkohësisht, në rrethana të pazakonshme të pandemisë, mund të rezultojë me ndonjë lëshim të paqëllimshëm teknik, për çka ju kerkojmë falje paraprakisht dhe ju falënderojmë për mirëkuptim!

Për: Shpejtim Bulliqi, Kryetar i komunës

Adresa: Rruga "Nuhi Gashi, Podujevë, Republika e Kosovës

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Podujevës (Komuna e Podujevës), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Podujevës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Gjatë verifikimit të plotësisë së regjistrit të pasurive, kemi gjetur se:
- pasurive kapitale dhe jo kapitale të blera gjatë vitin 2020, me vlerë prej 810,567€, nuk ishin të evidentuara në regjistrin e pasurive; dhe
 - Në regjistrin e pasurive figurojnë automjete në vlerë prej 21,900€, përkundër që nuk ishin në posedim të komunës (të shitura apo transferuara tek OB tjera);

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar gjithashtu pajtueshmërinë e menaxhmentit të Komunës së Podujevës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Podujevës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Komuna kishte lidhur kontratë prej blerjen e një Kamioni për departamentin e zjarrfikësve në vlerë prej 69,500€ duke anashkaluar procedurat e përcaktuar të prokurimit publik.
- B2 Në kontratën për "Riparimin e rrugëve të asfaltuara" komuna kishte lidhur kontratë kornizë për njësi në vlerë prej 185,700€. Gjatë realizimit të kontratës komuna ka bërë tejkalim të pozicionit nr. 2.4 për 13,474€ apo 29%.
- B3 Në shtatë (7) raste pagesat e faturave në vlerë prej 164,539€ për investimet kapitale nuk janë paguar në afatin e paraparë ligjor. Vonesat ishin nga 10 ditë deri në 4 muaj.
- B4 Komuna kishte paguar si avanc - paradhënie 20,850€ për blerjen e Kamionit për zjarrfikës. duke tejkaluar limitin ligjor duke paguar 30% të vlerës së kontratës. Vlera e tejkalimit ishte 10,425€.
- B5 Në katër (4) raste menaxherët e kontratave kishin aprovuar ndryshime të pozicioneve të kontratës pa një aprovim paraprak nga Zyrtari Kryesor Administrativ.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Theksimi i Çështjes

- 1 Komuna gjatë vitit 2020 kishte paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 148,878€ në kategori ekonomike jo adekuate. Nga kategoria e investimeve kapitale janë paguar 18,797€ për shpenzime të cilat i takojnë kategorisë së mallrave e shërbimeve. Nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve ishin paguar 122,978€ për shpenzime të cilat i takojnë kategorisë së investimeve kapitale si dhe 6,578€ për paga përcjellëse dhe shpërblime jubilarë. Kurse nga subvencionet dhe transferet janë paguar 525€ për pagën jubilarë me rastin e pensionimit. Duke qenë se çështja në fjalë është mjaft e përhapur në shumë organizata buxhetore dhe po përsëritet për vite me radhë, ajo do të trajtohet më hollësisht në Raportin e auditimit të Pasqyrave Financiare të Qeverisë, ku edhe do të jepen rekomandimet përkatëse për zgjidhje afatgjatë.

Opinioni i auditimit nuk është modifikuar për shkak të kësaj çështje

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Podujevës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Podujevës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Podujevës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Podujevës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Podujevës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.


Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve (siç janë paraqitur në Grafikon 1, më poshtë) dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalljet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Grafiku 1. Lloji i gjetjeve sipas kategorive ekonomike⁴



Ne po ashtu, kemi rishikuar statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe kemi vlerësuar nivelin e zbatimit të tyre. [Për detajet shih kapitullin 4].

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Evidenca jo të plotë dhe parregullsi në regjistrat e Pasurisë

Gjetja

Sipas Neni 22.3 të rregullores MF - nr. 02/2013 - për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t'i nënshtrohen normave të zhvlerësimit, po ashtu sipas nenit 6. pika 3 pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria" si dhe neni 7.1 Të gjitha lëvizjet e pasurive jo financiare (pranimi, shitja, dhurimi, transferimi dhe asgjësimi) të cilat rezultojnë në ndryshimin e përgjegjësisë menaxheriale dhe përdorimit duhet të mbështeten në dokumente përkatëse.

Në regjistrat e pasurive kemi evidentuar mangësitë si në vijim:

- Gjatë verifikimit të plotësisë së regjistrit të pasurive, kemi gjetur se, pasuri kapitale dhe jo kapitale të blera në vitin 2020, me vlerë prej 810,567€*, nuk ishin të evidentuara në regjistrin e pasurive;
- Në regjistrin e pasurisë kapitale, figuronin ende gjashtë automjete që ishin shitur përmes ankandit, por nuk ishin shlyer nga regjistrat. Vlera e përgjithshme e automjeteve ishte 11,400€ sipas vlerës fillestare pasi që nuk ishte aplikuar zhvlerësimi. Po ashtu në regjistër figuronin edhe tri automjete të njësisë së zjarrfikësve të regjistruara në vitin 2007, në vlerë 10,500€. Dy prej tyre janë dorëzuar tek Agjencia për Menaxhim Emergjent ndërsa një automjet është shitur në ankand publik. Regjistri i pasurisë ishte mbivlerësuar për 21,900€; dhe
- Pasuria nën 1,000€ e paraqitur në PFV prej 1,477,962€ ishte sipas vlerës fillestare, duke mos aplikuar fare zhvlerësimin. Po ashtu, pasuritë nën 1,000€, të cilat janë në drejtorin e arsimit dhe shëndetësisë, prej 1,379,314€ edhe pse të shpalosura në PVF, nuk janë të regjistruara në sistemin e-pasurisë. Kjo ka ndodhur për shkak se zyrtari i pasurisë nuk e përdor sistemin "e-pasuria.

Zyrtari i pasurisë kishte dërguar kërkesën në Ministrinë e Financave, që pasuritë e shitura me ankand të shlyhen mirëpo ende nuk janë larguar nga regjistrat.

Ndikimi Mos regjistrimi i të gjitha pasurive, rrit rrezikun që komuna mos të ketë nën kontroll, të gjitha asetet e saj dhe të ketë mangësi në raportim. Azhurnimi jo i rregullt i regjistrit të pasurive duke mos shlyer pasuritë e shitura apo të dhuruara ka ndikuar që pasurit kapitale të mbivlerësohen. Po ashtu, mos zhvlerësimi i pasurive jo financiare ka ndikuar që pasurit nën 1,000€, të mbivlerësohen.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurohet se sistemi e-Pasuria përdoret nga zyrtari i pasurisë dhe se aplikohet norma e zhvlerësimit. Të gjitha pasuritë mbi dhe nën 1,000€ duhet të regjistrohen në sistemet përkatëse në mënyrë që të ulët rreziku i keqpërdorimit apo humbjes së pasurisë. Po ashtu, Kryetari në bashkëpunim me MF, të sigurohet se për pasuritë e shitura apo të dhuruara merren veprimet e nevojshme që ato fshihen nga regjistrat e pasurive.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Anashkalimi i procedurave të prokurimit

Gjetja Sipas nenit 3.5 të ligjit të prokurimit publik, ky ligj nuk zbatohet për aktivitetet e prokurimit që qojnë në dhënien e një kontrate publike, që bie në fushën e veprimit të një marrëveshje, që parashikon zbatimin e rregullave dhe/ose procedurave të tjera të prokurimit, ku (i) kjo marrëveshje e kushtëzon disponueshmërinë e financimit të kontratës në fjalë me zbatimin e rregullave dhe/ose procedurave të tjera, dhe (ii) marrëveshja është lidhur ndërmjet Qeverisë dhe një institucioni financiar ndërqeveritar, dypalësh, shumëpalësh ose ndërkombëtar.

Komuna kishte lidhur kontratë prej blerjen e një Kamioni për departamentin e zjarrfikësve në vlerë prej 69,500€ duke anashkaluar procedurat e përcaktuar të prokurimit publik. Komuna kishte nënshkruar një marrëveshje me Ambasadën Japoneze ku financimi ishte nga Qeveria Japoneze, por që në marrëveshje nuk kishte ndonjë kusht që e përjashton aplikimin e procedurave të prokurimit.

Sipas marrëveshjes në mes komunës dhe donatorit nuk është parashikuar zbatimi i rregullave dhe/ose procedurave të tjera të prokurimit.

Ndikimi Mos aplikimi i procedurave të prokurimit, zvogëlon konkurrencën dhe transparencën për shpenzimin e parasë publike dhe komuna mund të marrë produkte me çmime jo të favorshme

Rekomandimi A1 Kryetari të sigurohet se blerja e shërbimeve apo produkteve të bëhet sipas procedurave adekuate të prokurimit. Në rastet kur financimi është nga donatorët të definohet me marrëveshje të financimit/grantit se çfarë procedura të prokurimit parashikohen të zhvillohen.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Tejkalimi i kontratës kornizë**Gjetja**

Sipas nenit 3.1 të kontratës sasi të realizuara nuk mund dhe nuk duhet ndryshuar nga raportet sipas peshës së dhënë në dosjen e tenderit. Menaxheri i kontratës mbetet përgjegjës që të dëshmojë në mënyrë të qartë se sasi të porositura dhe shpenzuara janë në harmoni me peshën e dhënë.

Në kontratën për “Riparimin e rrugëve të asfaltuara” komuna kishte lidhur kontratë kornizë për njësi në vlerë prej 185,700€. Sipas kësaj kontrate pozicionet janë peshuar dhe gjatë realizimit kemi tejkalim të pozicionit nr. 2.4 për 13,474€ apo 29%. Vlera totale e pozicionit nr. 2.4 sipas kontratës është 46,425€ kurse me dy situacione ky pozicion është paguar në vlerën 59,899€.

Kjo sipas menaxherit të kontratës ka ndodhur për shkak se janë riparuar disa rrugë që nuk kanë qenë të planifikuar të riparohen gjatë vitit 2020.

Ndikimi

Porositja e shërbime apo punëve dhe tejkalimi i pozicioneve tregon dobësitë e kontratës dhe kontrollet e ushtruara nga menaxhmenti i lartë duke sjellur edhe vështirësi financiare. Kjo praktikë ndikon që buxheti të shpenzohet pa planifikim paraprak.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të sigurohet përmes menaxherëve të kontratës se po respektohen kushtet e kontratës kur porositen shërbime apo punë të nevojshme. Po ashtu, të mos lejohet tejkalimi i sasive të parashikuara përtej limiteve të lejuara për kontratat kornizë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B3 - Vonesa në pagimin e faturave****Gjetja**

Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për MFPP, Çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Në shtatë (7) raste pagesat e faturave në vlerë prej 164,539€ për investimet kapitale nuk janë paguar në afatin e paraparë ligjor. Vonesat ishin nga 10 ditë deri në 4 muaj.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së mjeteve.

Ndikimi

Vonesat në realizimin e pagesave ndikojnë që Komuna të jetë subjekt i padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/ përmbarimore për Komunën.

Rekomandimi B3

Kryetari të sigurohet që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor dhe punët apo furnizimet të bëhet vetëm atëherë kur komuna paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja B4 - Pagesa e avansit në kundërshtim me ligjin e buxhetit**

Gjetja Sipas nenit 13.1 të Ligji nr. 07/001 mbi ndarjet buxhetore, paradhënia është e kufizuar deri në pesëmbëdhjetë për qind (15%) të vlerës së kontratës.

Komuna kishte paguar si avanc - paradhënie 20,850€* (avanci ishte paraparë me kontratë) për blerjen e Kamionit për zjarrfikës. Komuna kishte tejkaluar limitin ligjor duke paguar 30% të vlerës së kontratës. Vlera e tejkalimit ishte 10,425€.

Nuk kemi marrë ndonjë sqarim konkret nga ana e zyrtarëve komunal, në lidhje me pagesën e avansit përtej limitit.

Ndikimi Pagesat përtej limiteve të lejuara nga Thesari kanë ndikim të drejtpërdrejt në mirëmbajtjen e balancit nga ana e thesarit të e parave të gatshme në dispozicion për përdorim nga ana e organizatave buxhetore. Pagesat e tilla mund të sjellin komplikime në realizimin e projekteve tjera buxhetore si shkak i mungesës së parave të gatshme.

Rekomandimi B4 Kryetari të sigurohet që çdo herë kur paguhen avanse të respektohen kufizimet ligjore të përcaktuara me ligjin e buxhetit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Dobësi në menaxhim të kontratës

Gjetja Sipas nenit 61.23 të Rregullve dhe udhëzuesi operativ për prokurimin publik ndryshimi i kontratës nuk do t'i lëshohet operatorit ekonomik para marrjes së aprovimit nga Zyrtari Kryesor Administrativ.

Në katër (4) raste menaxheret e kontratave kishin aprovuar ndryshime të pozicioneve të kontratës pa një aprovim paraprak nga Zyrtari Kryesor Administrativ, rastet janë si në vijim:

- Në dy pagesa në vlerë prej 99,744€, për kontratën "Zgjerimi dhe rregullimi i lumit Llap" (vlera e kontratës 326,801€), nga vizita në teren kemi vërejtur se menaxheri i kontratës ka bërë aprovimin dhe pranimin e punimeve jo sipas përshkrimit të pozicioneve të kontratës. Sipas paramasës vendosja e gurëve në koshat e gabioneve është kontraktuar të jenë nga 10-20cm mirëpo aty janë vendosur gurë të pa klasifikuar nga 1cm e më shumë. Vlera e punimeve të realizuara në këtë pozicion është 22,050€;
- Në pagesën në vlerë prej 30,000€ për kontratën "Renovimi i hyrjeve dhe korridoreve të banesave" (vlera e kontratës 96,932€), nga vizita në teren kemi vërejtur se menaxheri i kontratës ka bërë aprovimin dhe pranimin e punimeve jo sipas përshkrimit të pozicioneve të kontratës. Pozicioni - Furnizimi dhe montimi i dyerve nuk ishte bërë me profil t=8cm dhe me xham të trefishtë, por ishte bërë me profil 4.5cm dhe me dy xhama. Banorët e hyrjeve nuk ishin furnizuar me kartela elektronike për hapjen e derës se hyrjes siç ishin kontraktuar. Gjithashtu edhe Furnizimi dhe montimi i ramëve (dritareve statike) për ndriçimin e shkallëve prej materialit të plastikës nuk ishte vendosur me profil me trashësi t=8cm dhe me tre mbyllje gome siç ishte kontraktuar por ishte vendos me profil t=7cm dhe me dy goma mbyllëse. Vlera e pozicioneve të realizuara jo sipas kontratës ishte 26,950€;
- Në pagesën në vlerë prej 10,336€ për kontratën "Ndërtimi i kalesave Popov-Sllatin-Pollat" (vlera e kontratës 47,467€), menaxheri ka aprovuar ndryshime të pozicioneve të kontratës në vlerë prej 7,680€ apo 16% të kontratës; dhe
- Në kontratën "Meremetimi i rrugëve me zhavorr" në vlerë prej 143,883€, menaxheri i kontratës kishte aprovuar ndryshime të pozicioneve të kontratës në vlerë prej 36,170€ apo 25%, por pa u tejkualuar vlera e përgjithshme e kontratës.

Sipas zyrtarëve përgjegjës ndryshime janë bëra për tu përshtatur nevojave të situatave të terrenit apo kërkesave të qytetarëve.

Ndikimi

Mangësitë në menaxhimin e kontratave zvogëlojnë sigurinë që kontratat janë duke u realizuar në përputhje me kushtet dhe specifikat e kontratës dhe ndikojnë në kualitetin e punimeve. Mos respektimi i kritereve të vendosura në dosjen e tenderit mund të rezultojë me pagesa të parregullta dhe vlerë të ulët për para.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të sigurojë respektimin e rregullave të prokurimit, në lidhje me menaxhimin e kontratave. Gjithashtu edhe menaxheri i kontratës duhet të veprojë në bazë të kompetencave me qëllim të respektimit të rregullave dhe mos tejkalimit të kompetencave dhe sa herë që paraqitet nevoja për ndryshime të kontratës të bëjë kërkesë për aprovim të ndryshimeve duke arsyetuar kërkesën për ndryshim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Gjetjet për çështjet e menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna në 2020 ishin në vlerë 936,982€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj.

Çështja A2 - Mos verifikimi i gjendjes aktuale të pronave

Gjetja Sipas nenit 15 të Ligjit nr. 06/L-005 për Tatimin në pronën e paluajtshme, Komuna çdo vit duhet të kryejë veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha pronave brenda territorit të Komunës.

Nga 28,139 prona të evidentuara në bazën e të dhënave, Komuna në vitin 2020 kishte arritur të verifikoj 2,551 apo 9% të pronave të paluajtshme.

Sipas zyrtarëve komunal kjo ka ndodhë për shkak të kufizimeve të lëvizjes si rezultat i pandemisë Covid-19.

Ndikimi Verifikimi i ulët i pronave, mund të rezultojë me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe të ndikoj në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të siguroj arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor. Përmirësimi në mbledhjen e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për Komunën është 12,346,020€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 1,992 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 1,900. Gjatë vitit 2020 ishin punësuar 21 zyrtarë. Kemi testuar 42 mostra për teste substanciale në vlerë 21,801€, si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A3 - Angazhimi për shërbime të veçanta pa kryer procedurat ligjore

Gjetja

Ligji për zyrtarët publik nr. 06/L-114 në nenin 84 thekson se Marrëveshjet për shërbime të veçanta, lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik. Sipas paragrafit 4 të ndryshim plotësimit të rregullave të KRPP-së për prokurim të shërbimeve të veçanta (konsulent/kontraktorët individual) këto rregulla aplikohen vetëm për prokurimin e shërbimeve të veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit.

Komuna gjatë vitit 2020 kishte angazhuar 64* zyrtarë për shërbime të veçanta, këta zyrtarë ishin angazhuar për pozitat infermierë, zyrtar ligjor, zyrtar për bujqësi, për tarifa, roje, zjarrfikës, punëtorë teknik, etj. Ne analizuam rastet e angazhimit pas hyrjes në fuqi të Ligji për zyrtarët publik*, dhe verifikuam se në 38 raste të angazhimeve kontratat ishin nënshkruar pa udhëhequr ndonjë procedurë të prokurimit.

Sipas menaxhmentit kjo ishte rezultat i mungesës së pozitive të aprovuara në planifikimin e buxhetit, mirëpo komuna ka pasur të aprovuar me ligjin e buxhetit rreth 90 pozita, më shumë se sa numri i të punësuarave.

Ndikimi

Anashkalimi i procedurave të prokurimit në lidhje me mbulimin e pozitive për shërbime të veçanta, përveç mosrespektimit të procedurave ligjore po ashtu e rrit edhe rrezikun e angazhimit të personave jo adekuat për pozita dhe detyrat e caktuara, çka mund të reflektoj edhe në performancë e tyre në punë.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jetë në gjendje të përmbushin detyrat e kërkuara. Po ashtu, menaxhmenti duhet të përkujdeset që angazhimet për pozitat e rregullta të zhvillohen përmes procesit të rregullt të rekrutimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 1,316,042€, prej tyre në 2020 ishin shpenzuar 1,122,703€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me subvencionimin e fermerëve, organizatave joqeveritare (OJQ), bursa të studentëve dhe nxënësve, mbështetje individuale tek shëndetësia si dhe mbështetje për aktivitete kulturore dhe sociale, etj.. Kemi testuar 5 mostra për teste substanciale në vlerë 81,190€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A4 - Mos respektimi i kriterëve për dhënien e subvencioneve

Gjetja

Sipas ftesës publike[1] për subvencionim me mullinj për prodhimin e ushqimit për kafshë përfituesit duhen të dorëzojnë vërtetimin nga AVUK me të cilin dokumentojnë se posedojnë të paktën shtatë (7) krerë gjedhe apo 3,000 shpezë dhe vërtetimin e tatimit në pronë se nuk kanë obligime ndaj komunës.

Në dy raste kemi vërejtur që përfituesit e subvencioneve ishin shpërblyer me pajisje - mullinj për prodhimin e ushqimit për kafshë (vlera për një pajisje - mullinj ishte 989€) pa i përmbushur kriteret e kërkuara sipas ftesës publike. Rastet dhe mangësitë janë si në vijim:

- Përfituesi kishte dorëzuar vërtetimin nga një ambulancë veterinerë për posedimin e shtatë (7) krerë gjedhesh, mirëpo nga dokumentet e aplikimit është vërejtur se tre (3) nga shtatë (7) gjedhet ishin me numër identifikues të një fermeri tjetër. Nga ekzaminimi i ekipit të auditimit në teren është vërejtur se ky përfitues nuk posedonte asnjë gjedhe. Komisioni i vlerësimit të aplikacioneve nuk e kishte identifikuar këtë mangësi; dhe
- Përfituesi nuk kishte bashkangjitur vërtetimin e tatimit në pronë me të cilën dokumentonte se nuk kishte borxh ndaj komunës si dhe kishte aplikuar dy ditë pas afatit (Aplikim 28.07.2020 kurse afati për aplikim 24.07.2020). Edhe ky si të gjithë aplikuesit tjerë kishte ofruar vërtetimin nga një ambulancë veterinerë e jo nga AUV për të dokumentuar numrin e gjedheve/shpezëve.

Kjo ka ndodhur për shkak se komisioni nuk ka bërë një shqyrtim të drejtë të aplikacioneve duke mos bërë krahasimin ndërmjet aplikacioneve, dëshmitë e bashkangjitura në raport me kriteret e vendosura.

Ndikimi

Anashkalimi i kriterëve me thirrjen publike ka rezultuar që të përzgjidhen përfituesit që nuk i kanë përmbushur kriteret e përcaktuar duke subvencionuar fermerë jo adekuat.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të sigurojë që përzgjedhja e përfituesve nga komisionet bëhet vetëm pasi të jenë plotësuar kërkesat e përcaktuara me thirrjen për aplikim. Po ashtu, gjatë vendosjes së kriterëve në ftesa publike të qartësohet saktësisht se nga cili institucion relevant dhe i besueshëm plotësohen kriteret e kërkuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B6 - Mungesa e planit të subvencionimit të OJQ-ve

Gjetja

Sipas nenit 6 të rregullores 04/2017 mbi Kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Ofruesit e mbështetjes financiare duhet të përgatisin planin vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës dhe ta dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

Komuna nuk kishte përgatitur plan vjetor për subvencionimin e OJQ-ve i cili do duhej të dorëzohet pranë zyrës së Kryeministrit, edhe pse gjatë vitit kishte subvencionuar OJQ-të me rreth 500.000€.

Kjo kishte ndodhur pasi që Zyrtaari Kryesor Administrativ nuk kishte deleguar përgjegjësi për hartimin e planit për financim të OJQ-ve tek përgjegjësit e programeve që bëjnë shpërndarje të subvencioneve.

Ndikimi

Mungesa e planit për financimin e OJQ-ve, mund të ndikojë që të financohen projekte me më pak prioritet, ndërsa projektet që kanë rëndësi më të madhe për publikun dhe komunën të mos realizohen.

Rekomandimi B6

Kryetari duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia te zyrtarët kompetent për përgatitjen e plani vjetor të financimit të OJQ-ve, dhe të njëjtin ta dërgojnë në zyrën e Kryeministrit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 10,623,624€, prej tyre ishin shpenzuar 8,937,496€. Ato kanë të bëjnë kryesisht për ndërtimin e rrugëve, kanalizimit, ndërtim shkolle, etj. Kemi testuar 54 mostra për teste substanciale në vlerë 1,320,555€, si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B7 - Specifikimi teknik jo i qartë

Gjetja

Sipas nenit 28.4 të LPP-së, autoritetet kontraktuese do të formulojnë specifikimet teknike duke iu referuar (i) një standardi të Kosovës që implementon një standard Evropian, (ii) një standardi Evropian. (iii) një miratimi teknik Evropian, (iv) një specifikimi të përbashkët teknik, (v) një standardi ndërkombëtar apo (vi) çfarëdo referimi tjetër teknik të nxjerrë nga organet Evropiane për standardizim, gjithashtu neni 28.8 "Kërkesat ekzekutuese dhe funksionale duhet të jenë të sakta në mënyrë që të iu mundësoj tenderuesve që të përcaktojnë lëndën kryesore të kontratës dhe t'i lejoj autoritetet kontraktuese që të shpërblejnë kontratën.

Në tri raste gjatë shqyrtimit të procedurave të prokurimit kemi hasur në këto mangësi:

- Për ndërtimin e shkollës "Ali Ajeti" në fshatin Ballofc, komuna ka lidhur kontratë në vlerë prej 384,444€. Në formulimin e specifikave teknike ishin bërë përshkrime jo të saktë dhe jo të matshëm të pozicioneve si: Kalldaja me pelet- nuk ishte përcaktuar kapaciteti i rezervarit të peletit, Gypat Al-PVC fi16*2mm - nuk ishte përcaktuar qëndrueshmëria apo rezistenca ndaj temperaturës, Furnizim me pllaka të qeramikës së kualitetit të lart pa dhënë specifika tjera të plakës për të përcaktuar se si do të matet kualiteti;
- Komuna ka lidhur kontratë në vlerë prej 249,634€, për Ndërtimin dhe rregullimin e shtratit të lumit Llap. Në formulimin e specifikave teknike komuna nuk ka përcaktuar standardin e cilësisë së punimeve apo produkteve të kërkuara, duke kërkuar vetëm Beton C25/30, nuk ka përcaktuar metodën apo standard prodhimi sipas të cilit bëhet kontrolli i cilësisë së betonit. Po ashtu, nuk është përcaktuar standardi i cilësisë dhe elasticitetit të armaturës që do të furnizohet; dhe
- Komuna ka lidhur kontratë në vlerë prej 173,976€, për Meremetimin e rrugëve me zhavorr. Formulimi i specifikave teknike ishte bërë jo i saktë dhe jo i matshëm për pozicionin -Hapja e kanaleve për largimin e ujërave atmosferike- pa përcaktuar thellësinë dhe gjerësinë apo dhe formën e kanalit.

Kjo ka ndodhur për shkak se njësitë kërkuese nuk kanë bërë rishikim adekuat dhe në mënyrë profesionale për të eliminuar paqartësitë dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk ka ushtruar kontrole të mjaftueshme për të parandaluar këtë mangësi.

Ndikimi Mos përcaktimi i saktë i standardit të kualitetit të punimeve apo produkteve të kërkuara ndikon që mbikëqyrja e kontratave të mos jetë efikase dhe punimet të kryhen me kualitet të dobët. Kjo bënë që operatorët ekonomik të jenë të keq orientuar dhe mund të ndikoj në ofertën financiare dhe çmimin e kontratës.

Rekomandimi B7 Kryetari duhet të sigurohet që njësitë kërkuese bëjnë hartimin e specifikimeve teknike sipas kërkesave ligjore dhe nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit dhe zyra e prokurimi të forcoj kontrollet e tyre duke mos lejuar që dosja e tenderit të publikohet me pozicione jo të qarta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Pranimi i punëve/furnizimeve të porealizuara apo jo sipas kontratës

Gjetja Sipas nenit 61.19 të RrUOPP, menaxheri i projektit do të sigurojë se: Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë dhe nenit 20.1 të kushteve të përgjithshme të kontratës, Furnizimet nuk do të pranohen derisa të jenë realizuar verifikimet dhe testet e caktuara. Inspektimet dhe testet mund të realizohen para transportit, në pikën e dorëzimit dhe/ose në destinimin final të mallrave.

Nga ekzaminimet fizike kemi hasur parregullsi në pranimin e punëve apo furnizimeve të kontratave si në vijim:

- Te pagesa në vlerë 30,000€ për kontratën “Renovimi i hyrjeve dhe korridoreve të banesave”, (vlerë e kontratës 96,962€), nga ekzaminimi i pjesshëm në teren kemi vërejtur se te situacioni II tek pozicioni (Furnizimi dhe montimi i ramëve prej materialit të plastikës me trashësi të profilit t=8cm dhe me tre mbyllje gome), ishin pranuar dhe paguar si punë të përfunduara 3,678€ më shumë se sa realisht ishin kryer punime; dhe
- Te pagesa në vlerë prej 29,840€ për kontratën “Furnizim të një autoambulance me pajisje të reanimimit për nevoja të QKMF-së” (vlera e kontratës 59,840€), nga ekzaminimi fizik i autoambulancës dhe pajisjeve kemi vërejtur se furnizimet nuk ishin realizuar sipas kontratës në këto pozicione:
 - Sipas kontratës dyshemeja duhej të ishte antibakteriale dhe e pa rrëshqitshme. Çertifikatat që e dokumentojnë se dyshemeja është e pa rrëshqitshme dhe padepërtueshme nga uji nuk na janë ofruar. Gjithashtu Interieri do të duhej të ishte i puthitur mirë, mirëpo dyshemeja e autoambulancës nuk ishte e puthitur mirë për muri dhe ka filluar të largohet;
 - Kabineti për terapinë medicinale - ana e majtë e autoambulancës pjesa e pacientit, sipas specifikimit teknik të kontratës do të duhej të ishte e pajisur me raftë sa tërë gjatësia dhe lartësia e autoambulancës për vendosje të pajisjeve dhe medikamenteve. Autoambulanca e pranuar kishte vetëm një pjesë me raftë por jo siç ishte specifikuar në kontratë.
 - Në çati sipas specifikimit teknik të kontratës do të duhej të kishte të vendosura dy mbajtëse dorës 1200mm nga kromi. Autoambulanca i kishte të vendosura dy mbajtëse nga metali i ngjyrosur e jo nga kromi;
 - Defibratori bifazik manual me monitor nuk është sipas specifikimit teknik të kontratës por është defibrator AED apo defibrator mobil automatik; dhe
 - Testeri për alkool me ekran digjital, në raportin e pranimit figuron se është pranuar, mirëpo gjatë ekzaminimit fizik nuk na është ofruar.

Nuk kemi marrë ndonjë sqarim konkret nga ana e zyrtarëve komunal, në lidhje me pranimin e punëve/furnizimeve të porealizuara.

Ndikimi

Pagesa e punëve dhe furnizimeve të cilat komuna nuk i kishte pranuar dëmtojnë buxhetin e komunës po ashtu rrezikon që kontrata të mos përmbushet në tërësi si rezultat i mungesave potenciale të buxhetit. Më tutje, pranimi i autoambulancës pa i plotësuar të gjitha kriteret përkatëse rrezikon që gjatë shfrytëzimit të mos arrijë qëllimin e saj.

Rekomandimi A5

Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e menaxhimit të kontratave për tu siguruar se pagesat do të realizohen vetëm pas ofrimit të dëshmimeve të mjaftueshme për kryerjen e punëve/shërbimeve të kontraktuara në përputhje me kushtet.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.5 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 92,862,112€, pasurive jokapitale është 1,477,962€, si dhe e stoqeve 103,450€. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 8,973,905€, si dhe 8 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B8 - Mangësi në menaxhimin e pasurisë.

Gjetja

Sipas nenit 19.4.3 të rregullores MF- nr. 02/2013 - për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore - Komisioni për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare është përgjegjës për krahasimin e gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare dhe identifikimin e pasurisë që nuk ka vlerë të bartur. Po ashtu, sipas nenit 4.1 Zyrtari Kryesor Administrativ është përgjegjës për aprovimin e rregullave dhe procedurave të brendshme për evidencën.

Komuna ka realizuar inventarizimin e pasurisë për vitin 2020, megjithatë raportet e inventarizimit nuk janë harmonizuar/krahasuar me regjistrin e përgjithshëm të pasurisë në SIMFK dhe me regjistrin e-pasuria.

Komuna nuk ka aprovuar rregulla dhe procedura të brendshme për ndarjen e drejt të detyrave për regjistrimin dhe raportimin e pasurive, evidencën dhe ruajtjen e pasurive, ngarkimin e pasurive tek personat përgjegjës që do të kujdeseshin për pasuritë e ngarkuara apo edhe procedurën e inventarizimit dhe krahasimit.

Kjo ka ndodhur për shkak të mos funksionimit adekuat të kontrolleve të brendshme të komunës sa i përket fushës së pasurisë.

Ndikimi

Mungesa e rregullave të brendshme dhe mos krahasimi i raporteve të inventarizimit me regjistrat e pasurisë ka vështirësuar menaxhimin efektiv të pasurisë dhe për rrjedhojë vlera e paraqitur në PFV nuk është e saktë, pra nuk është prezantuar gjendja reale e pasurisë me të cilat disponon komuna.

Rekomandimi B8

Kryetari duhet të siguroj se bëhet krahasimi i raporteve të inventarizimit me regjistrat e pasurisë si dhe të azhurnohen regjistrat e pasurisë sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit. Gjithashtu të siguroj se është duke u respektuar rregullorja për pasuritë financiare dhe jo financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.6 Të arkëtueshmet

Pasqyra e llogarive të arkëtueshme në fund të vitit 2020, ishte 8,033,611€. Kjo vlerë përbehet nga tatimi në pronë 3,219,625€, taksa në firmë 3,866,421€, qiraja komunale 931,929€ shfrytëzimi i hapësirave publike 12,700€, dhe tjera 2,936€. Llogaritë e arkëtueshme nga viti paraprak ishin rritur për 267,507€.

Çështja B9 - Sfidat në menaxhimin e Llogarive të Arkëtueshme

Gjetja

Sipas nenin 26 të ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme 06-L 005, Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrueshëm. Sipas nenit 22.2 të rregullores për taksa tarifa dhe gjopa komunale, përcaktohet që të iniciohet procedura e ekzekutimit të dhunshëm në gjykatën kompetente dhe përmbarim privat mbledhja e llogarive të arkëtueshme. Në kontratat e lidhura në mes të komunës dhe qiramarrësve janë paraparë masat që duhet të ndërmarrën në rast të mos pagesës së qirasë sipas kriterëve të përcaktuara në kontratë.

Gjatë testimit të LLA-ve Komuna nuk kishte ndërmarrë veprime të mjaftueshme për arkëtimin e tyre. Ne identifikuam se:

- Për të arkëtueshmet e tatimit në pronë në vlerë 3,219,625€ komuna nuk kishte ndërmarr ndonjë aktivitet siç parashihet me ligjin për tatimin në pronë;
- Për të arkëtueshmet që i përkasin pronave të lëshuara me qira janë 931,929€, komuna kishte ndërmarr disa veprime duke i dërguar lëndët në përmbarim mirëpo jo në proporcion me obligimet; dhe
- Për të arkëtueshmet nga taksat në biznes kishin arritur vlerën 3,856,421€. Komuna nuk kishte ndërmarr veprime të cilat parashikohen me rregullore.

Sipas komunës gjendja ekonomike e sociale, ka sjell, deri te mos pagesa e borxheve tek tatimi në pronë, derisa sa i përket bizneseve aty ka shumë biznese joaktive.

Ndikimi

Mos arkëtimi i të arkëtueshmeve ndikon që ato të bëhen të pa mbledhshme duke krijuar një rast precedent për borxhlinjtë e tjerë të cilët mund të ndjehen të trajtuar në mënyrë jo të barabartë dhe gjithashtu rezulton fonde më pak për financimin e projekteve.

Rekomandimi B9

Kryetari, duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve. Po ashtu, duhet shqyrtuar gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

“Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁹	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Burimet e fondeve	26,756,268.00	27,926,070.82	24,798,321.30	23,612,093.78	18,815,507.10
Grante Qeveritare - Buxheti	22,669,707.00	22,434,775.91	20,457,168.64	19,751,426.15	17,719,674.29
Financimi përmes huamarrjes	0.00	222,578.00	185,183.29	41,774.09	24,338.45
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	2,670,000.00	2,670,000.00	2,616,508.26	2,411,285.55	0.00
Të bartura nga viti i kaluar	0.00	908,772.38	639,184.76	426,914.41	286,440.97
Të hyrat vetanake	1,416,561.00	1,416,561.00	719,769.36	751,271.58	643,912.72
Donacionet vendore	0.00	202,931.56	110,576.66	29,550.00	0.00
Donacionet e jashtme	0.00	70,451.97	69,930.33	199,872.00	141,140.67

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 1,169,801€. Kjo rritje është rezultat i rritjes së financimit nga huamarrja prej 222,578€, rritjes së të hyrave vetanake të bartura nga viti paraprak 908,772€, rritjes së donacioneve të brendshme me 202,932€ dhe të jashtme me 70,452€ dhe zvogëlimit të grantit prej 234,933€.

Në vitin 2020 Komuna ka shpenzuar 89% të buxhetit final ose 24,798,321€, me një përmirësim prej 5% në krahasim me vitin 2019 ku ishte 84%.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet	2018 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	26,756,268.00	27,926,070.82	24,798,321.30	23,612,093.78	18,815,507.10
Pagat dhe mëditjet	12,239,479.00	12,346,019.51	12,183,282.40	11,851,578.97	11,763,934.06
Mallrat dhe shërbimet	2,318,773.00	3,263,342.40	2,228,094.85	1,892,717.68	1,479,775.21
Komunalitë	415,000.00	377,043.28	326,745.34	395,150.30	321,170.51
Subvencionet dhe transferet	660,050.00	1,316,041.56	1,122,702.71	566,757.54	506,580.66
Investimet Kapitale	9,432,455.00	10,623,624.07	8,937,496.00	8,905,889.29	4,744,046.66
Rezervat	1,690,511.00	0.00	0.00	0.00	0.00

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final në raport me buxhetin fillestar për paga dhe mëditje ishte rritur për 106,539€ i cili ishte shpenzuar në nivel prej 99%.
- Buxheti final në raport me atë fillestar për mallra dhe shërbime ishte rritur për 944,569€, kjo është rezultat i rritjes së grantit për 881,345€, nga huamarrja prej 32,819€, të hyrave të bartura nga viti i kaluar për 29,983€ si dhe nga donacionet 422€. Përkundër kësaj realizimi i buxhetit ishte në nivel prej 68% kjo ishte rezultat i një planifikimi jo të duhur.
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,191,169€, përkundër kësaj vetëm 84% e buxhetit ishte shpenzuar. Në këtë nivel ka ndikuar zhvillimi i shumicës së procedurave të prokurimit në gjysmën e dytë të vitit.
- Buxheti final në raport me buxhetin fillestar për subvencione ishte rritur për 655,992€, kjo ishte rezultat i rritjes së grantit të përgjithshëm prej 286,800, të hyrave të bartura prej 236,380€ dhe donacioneve të brendshme 132,812€.

Si rezultat i situatës pandemike Covid-19 komuna kishte shpenzuar 695,429€ për këtë qëllim. Prej tyre 446,723€ shtesa në paga dhe 248,706€ mallra dhe shërbime.


Grafiku 2. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike gjatë periudhës 2018-2020



Shpenzimet e komunës ka pasur një trend të qëndrueshëm të rritjes nga viti në vit. Ndryshimi më i madh i rritjes së shpenzimeve vërehet nga viti 2018 në 2019 ku shpenzimet për investime kapitale janë rritur për 4,161,842€, kjo ka ndodhur për shkak të realizimi të projektit për kolektorin e ujrave të zeza të financuar nga huamarrja.

Gjithashtu kemi rritje theksuar të shpenzimeve për subvencione dhe transfere krahasuar me vitin paraprak, kjo është rezultat i përkrahjes së nivelit qendror të komunave për tejkalimin e efekteve negative të pandemis Covid-19 në ekonomin lokale.

Grafiku 3. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2020



Pjesën më të madhe të shpenzimeve e në strukturën së shpenzimeve të komunës e marrin paga dhe meditje me 49% pasuar nga investimet kapitale me 36% dhe mallrat shërbimet dhe komunalit 10%

Të hyrat e realizuara nga Komuna në 2020 ishin në vlerë 936,982€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Plani i të hyrave ka qene 1,416,561€ ndërsa komuna e ka realizuar 66% apo 936,982€, ku gjithashtu kemi edhe një rënie të të hyrave, por kjo është rezultat i pandemis Covid-19.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2020 Pranimet	2019 Pranimet	2018 Pranimet
Totali i të hyrave	1,416,561.00	1,416,561.00	936,982.01	1,204,632.57	1,107,380.56
Të hyrat tatimore	508,613.00	508,613.00	345,800.55	441,454.81	428,322.74
Të hyrat jo tatimore	907,948.00	907,948.00	591,181.46	763,177.76	678,979.16
Të hyrat tjera	0.00	0.00			78.66

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2019 të Komunës së Podujevës ka rezultuar në 15 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Komuna ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve (30.09.2020 dhe 15.03.2021) sipas kërkesave të daluara nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2020, tri rekomandime janë zbatuar, nëntë nuk janë zbatuar dhe tri nuk aplikohen më, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve). (Vëni re se kur ceket fundi i auditimit, i referohemi fundit të procesit të auditimit - deri në momentin kur e dërgojmë raportin e këtij viti)

Grafiku 4. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2020

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2019	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari i komunës duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që të shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestininim të mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Edhe këtë vitë komuna nuk kishte planifikuar drejt buxhetin me cka bërë që të ekzekutoj pagesa nga kategorit jo adekuate. Mirëpo kjo çështje do të trajtohet në RVA	Nuk është i aplikueshëm më

2.	Pagat dhe mëditjet	Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë se punonjësit me kontrata për detyra specifike të angazhohen vetëm në rastet kur ka kërkesa specifike dhe angazhimet për këto shërbime nuk duhet të zgjasin më shumë se katër muaj. Po ashtu, pozitat e rregullta të punës të mos mbulohen me kontrata për detyra specifike dhe marrëveshjeve për shërbime të veçanta. Gjithashtu duhet të zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit për marrëveshjet për shërbime të veçanta.	Edhe këtë vit komuna ka pasur punëtorë me kontrata për detyra specifike dhe shërbime të veçanta dhe për periudhe më të gjatë se sa lejon ligji. Mirëpo nga viti 2020 kemi ndryshim të bazës ligjore dhe rekomandimi është dhënë konformë ligjit të ri tek A3	Nuk është i aplikueshëm më
3.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia te zyrtarët kompetent për përgatitjen e plani vjetor të financimit të OJQ-ve, dhe të njëjtin ta dërgojnë në zyrën e Kryeministrit.	Komuna nuk kishte pregaditur dhe dorezuar planin për subvencionim të OJQ në zyrën e kryeministrit.	Nuk ka filluar zbatim
4.	Investimet kapitale	Kryetari të sigurohet se kontrollet funksionojnë në mënyrë efikase gjatë gjithë kohës nga zyra e prokurimit duke mos lejuar që të publikohen dosje të tenderëve pa projekte ekzekutuese.	Nga procedurat e testuata ato kishin pasur plan detal të ndertimit.	I zbatuar
5.	Investimet kapitale	Rekomandimi A4 Kryetari të sigurohet se kontrollet funksionojnë në mënyrë efikase gjatë gjithë kohës nga zyra e prokurimit duke mos lejuar që të publikohen dosje të tenderëve duke përdorur emra tregtarë për plotësimin e nevojave të komunës	Edhe këtë vit nuk kanë funksionuar kontrollet që specifikacioni teknik të jetë i saktë.	Nuk ka filluar zbatim
6.	Investimet kapitale	Rekomandimi A5 Kryetari të sigurohet se komisioni për vlerësimin e ofertave të tenderit i trajton të gjitha ofertat në mënyrë të barabartë dhe vlerësimi i ofertave për tender bëhet në pajtim me kriteret e dosjes së ofertës për tender dhe LPP. Gjithashtu zyrtari përgjegjës i prokurimit sigurohet se është duke u zbatuar LPP në tërësi duke ushtruar funksionin e kontrollit për parandalim dhe korrigjim të gabimeve	Nga procedurat e shqyrtuara nuk kemi hasur vlerësim jo të drejtë.	I zbatuar
7.	Investimet kapitale	Rekomandimi A6 Kryetari të sigurohet që çdo herë që paguhen avanse të respektohen kufizimet ligjore të përcaktuara me ligjin e buxhetit.	Edhe këtë vit në kemi hasur që pagesa e avansit është tejkaluar limit ligjor për pagesen e avansit.	Nuk ka filluar zbatim

8.	Investimet kapitale	Rekomandimi A7 Kryetari të sigurohet se çdoherë të ketë një kontratë të vlefshme sipas ligjit të prokurimit publik kur porositen shërbime apo punë të nevojshme. Po ashtu, të mos lejohet tejkalimi i sasive të parashikuara përtej limiteve të lejuara për kontratat kornizë.	Edhe këtë vit në kemi hasur që është bërë tejkalimi i kontratave kornizë.	Nuk ka filluar zbatimi
9.	Investimet kapitale	Rekomandimi A8 Kryetari duhet të sigurojë respektimin e rregullave të prokurimit, në lidhje me menaxhimin e kontratave. Gjithashtu edhe menaxheri i projektit duhet të veprojë në bazë të kompetencave me qëllim të respektimit të rregullave dhe mos tejkalimit të kompetencave.	Edhe këtë vit gjatë menaxhimit të kontratave janë bërë ndryshime të kontratave pa aprovim paraprak nga ZKA.	Nuk ka filluar zbatimi
10.	Pasuritë	Rekomandimi A9 Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha blerjet dhe përvetësimet e pasurive kapitale regjistrohen saktë në regjistrin e pasurive nga zyrtari i pasurive në mënyrë që të ketë një regjistër të plotë të pasurive.	Komuna edhe këtë vit nuk ka regjistruar të gjitha pasuritë e blera përvetësuar gjatë viti 2020 dhe ato nga viti paraprak.	Nuk ka filluar zbatimi
11.	Pasuritë	Rekomandimi B2 Kryetari të sigurohet se për pasuritë e shitura apo të dhuruara të merren veprimet e nevojshme që ato fshihen nga regjistrat e pasurive. Gjithashtu të sigurohet se regjistrohen të gjitha pasuritë në sistemin "e-pasuria" dhe fillon të aplikohet norma e zhvlerësimit.	Komuna ende nuk i ka fshirë nga regjistri pasurive, pasuritë të cilat i kishte shitur. Ky rekomandim ende nuk është i zbatuar dhe gjendet te B1	Nuk është i aplikueshëm më
12.	Pasuritë	Rekomandimi A10 Kryetari të sigurohet se janë hartuar rregulla dhe procedura të brendshme për evidencën ruajtjen dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare. Pas përfundimit të çdo projektit zyrtari i pasurisë të sigurohet se bëhet regjistrimi i pasuri në përdorim. Gjithashtu të sigurohet se bëhen krahasimet e raporteve të inventarizimit me regjistrat pasurisë dhe të azhurnohen regjistrat e pasurisë sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit.	Komuna nuk ka bërë hartimin e rregulloreve të brendshme dhe nuk është duke bërë regjistrimin e pasurive drejt në regjistër	Nuk ka filluar zbatimi
13.	Llogaritë e arkëtueshme	Rekomandimi B3 Kryetari, duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve. Po ashtu duhet shqyrtuar gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.	Komuna nuk ka ndërmarr asnjë veprim gjatë viti 2020 për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme.	Nuk ka filluar zbatimi

14.	Obligimet e papaguara	Rekomandimi C1 Kryetari të sigurohet që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor dhe porositja e mallrave, punëve apo shërbimeve bëhet vetëm atëherë kur komuna paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë.	Edhe kete vit në shtatë raste është hasur që komuna nuk ka bërë pagesen e obligimeve ne kohë	Nuk ka filluar zbatim
15.	Obligimet e papaguara	Rekomandimi A11 Kryetari duhet të sigurojë se detyrimet financiare të prezantohen në pasqyrat financiare sipas kërkesave të rregullores për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.	Komuna ka bërë prezentim të drejt të obligimeve	I zbatuar

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurohet se sistemi e-Pasuria përdoret nga zyrtari i pasurisë dhe se aplikohet norma e zhvlerësimit. Të gjitha pasuritë mbi dhe nën 1,000€ duhet të regjistrohen në sistemet përkatëse në mënyrë që të ulët rreziku i keqpërdorimit apo humbjes së pasurisë. Po ashtu, Kryetari në bashkëpunim me MF, të sigurohet se për pasuritë e shitura apo të dhuruara merren veprimet e nevojshme që ato fshihen nga regjistrat e pasurive.
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurohet përmes menaxherëve të kontratës se po respektohen kushtet e kontratës kur porositen shërbime apo punë të nevojshme. Po ashtu, të mos lejohet tejkalimi i sasive të parashikuara përtej limiteve të lejuara për kontratat kornizë.
3.	Baza për konkluzion	Kryetari të sigurohet se blerja e shërbimeve apo produkteve të bëhet sipas procedurave adekuate të prokurimit. Në rastet kur financimi është nga donatorët të definohet me marrëveshje të financimit/grantit se çfarë procedura të prokurimit parashikohen të zhvillohen.
4.	Baza për konkluzion	Kryetari të sigurohet që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor dhe punët apo furnizimet të bëhet vetëm atëherë kur komuna paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë.
5.	Baza për konkluzion	Kryetari të sigurohet që çdo herë kur paguhen avanse të respektohen kufizimet ligjore të përcaktuara me ligjin e buxhetit.
6.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë respektimin e rregullave të prokurimit, në lidhje me menaxhimin e kontratave. Gjithashtu edhe menaxheri i kontratës duhet të veprojë në bazë të kompetencave me qëllim të respektimit të rregullave dhe mos tejkalimit të kompetencave dhe sa herë që paraqitet nevoja për ndryshime të kontratës të bëjë kërkesë për aprovim të ndryshimeve duke arsyetuar kërkesën për ndryshim.
7.	Të hyrat	Kryetari duhet të siguroj arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor. Përmirësimi në mbledhjen e të hyrave nga ky burim do të ndikoj drejtpërdrejt në realizimin e projekteve që kanë efekt në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët e komunës.
8.	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë se janë ndjekur të gjitha procedurat dhe hapat e prokurimit në angazhimin e kontraktorëve individual për shërbime të veçanta duke u kujdesur që personeli i angazhuar do të jetë në gjendje të përmbushin detyrat e kërkuara. Po ashtu, menaxhmenti duhet të përkujdeset që angazhimet për pozitat e rregullta të zhvillohen përmes procesit të rregullt të rekrutimit.
9.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë që përzgjedhja e përfituesve nga komisionet bëhet vetëm pasi të jenë plotësuar kërkesat e përcaktuara me thirrjen për aplikim. Po ashtu, gjatë vendosjes së kriterëve në ftesa publike të qartësohet saktësisht se nga cili institucion relevant dhe i besueshëm plotësohen kriteret e kërkuara.
10.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia te zyrtarët kompetent për përgatitjen e plani vjetor të financimit të OJQ-ve, dhe të njëjtin ta dërgojnë në zyrën e Kryeministrit.

11.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të forcojë kontrollet në procesin e menaxhimit të kontratave për tu siguruar se pagesat do të realizohen vetëm pas ofrimit të dëshmive të mjaftueshme për kryerjen e punëve/shërbimeve të kontraktuara në përputhje me kushtet.
12.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurohet që njësitë kërkuese bëjnë hartimin e specifikimeve teknike sipas kërkesave ligjore dhe nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit dhe zyra e prokurimi të forcoj kontrollet e tyre duke mos lejuar që dosja e tenderit të publikohet me pozicione jo të qarta.
13.	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj se bëhet krahasimi i raporteve të inventarizimit me regjistrat e pasurisë si dhe të azhurnohen regjistrat e pasurisë sipas të dhënave të regjistrimeve të fundit. Gjithashtu të siguroj se është duke u respektuar rregullorja për pasuritë financiare dhe jo financiare.
14.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari, duhet të siguroj që po shqyrtohen në mënyrë aktive të gjitha opsionet e mundshme, duke vendosur politika dhe rregullore me qëllim të rritjes së efikasitetit në mbledhjen e borxheve. Po ashtu, duhet shqyrtuar gjitha masat në pajtim me ligjin, ndaj operatorëve të cilët nuk i përmbushin obligimet.

Besnik Osmani, Auditor i Përgjithshëm



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Faruk Rrahmani, Udhëheqës i Auditimit




Elvir Krasniqi, Udhëheqës i ekipit



Abdurrahmon Bërbatovci, Anëtar i ekipit



Senver Morina, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi

				REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE							
DATE: 22.06.2021		Nr. Pror:		100		Nr. Pror:		100		Nr. Pror:	
Niveli Org:		Kod:		100		Niveli Org:		Kod:		100	
Org. Jedin:		Las. Cdo:		100		Org. Jedin:		Las. Cdo:		100	
Org. Unit:		Las. Cdo:		100		Org. Unit:		Las. Cdo:		100	
04		47		952		1		1		1	
Republika e Kosovës						Republika e Kosovës					
Republika Kosova – Republic of Kosovo						Republika Kosova – Republic of Kosovo					
Komuna e Podujevës						Komuna e Podujevës					
Opština Podujevo –Municipality of Podujeva						Opština Podujevo –Municipality of Podujeva					

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2020 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Podujevës, për vitin 2020.
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Kryetari

Shpejtim Balliçi

Data:

22.06.2021



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare¹⁰ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet.¹¹ Ky opinion duhet të veçohet nga opinioni nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, d.m.th. opinionin mund të modifikohet në lidhje me çështjen(t) e pajtueshmërisë, por mund të mos modifikohet në lidhje me besueshmërinë e pasqyrave financiare (ose anasjelltas).

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinionin i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Pasuritë e pa regjistruara janë; 1.Renovim i objekteve shkollore, 35,188€; 2.Zgjerimi ndërtimi dhe asfaltimi i rr. Zahir Pajaziti
- ⁶ Vlera e kontratës është 69,500€
- ⁷ [1] Komuna gjatë vitit 2020 kishte të angazhuar për shërbime të veçanta 64[1] persona. Zyrtarët ishin angazhuar në shëndetësi si infermierë, në administratë dhe drejtori tjera si zyrtar ligjor, për bujqësi, për tarifa, roje, zjarrëfikës, punëtorë teknik, etj. Ne analizuam rastet e angazhimit pas hyrjes në fuqi të Ligji për zyrtarët publik [2], dhe verifikuam se në 38 raste kontratat ishin nënshkruar pa udhëhequr ndonjë procedur të prokurimit. [2] 13 Korrik 2020, Aktvendimi i Gjykatës Kushtetuese
- ⁸ [1] Ftesa publike për aplikim me nr. prot. 12-320/01-0032122/20. Afati për aplikim prej datës 29.06.2020 deri 24.07.2020
- ⁹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ¹⁰ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ¹¹ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.